

L I G J

PER MBROJTJE TE KONSUMATOREVE GJATE MARREVESHJEVE PER KREDI KONSUMI

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 51/11; 145/15; 23/16; 20/19 "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.122/21)

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

- (1) Me kete ligj rregullohet mbrojtja e konsumatoreve gjate lidhjes dhe realizimit te marreveshjeve per kredi konsumi, ne vellim dhe per dedikimete parapara me kete ligj.
- (2) Per gjithckaqe nuk eshte rregulluar me kete ligj, ne marreveshje per kredi konsumi zbatohen dispozitat e Ligjit per marredhenie obliguese, e per mbrojtjete konsumatoreve dispozitate Ligjit per mbrojtje te konsumatoreve.
- (3) Nese nuk eshte rregulluar ndrysheme kete ligj, ne marreveshje per lizing financiar zbatohen dispozitat e Ligjit per lizing.

Perkufizime

Neni 2

Shprehjet e vecanta te perdorura ne kete ligj e kane kuptimin si vijojne:

1. "Konsumator" eshte personi fizik i cili lidh marreveshje per kredi konsumine pajtim me kete ligj, e per realizimin e qellimeve qe nuk lidhen me ushtimin e veprimtarise tregtare, afariste apo profesionale;
2. "Kreditor" eshte banka ose shoqeria tjeter tregtare dhe tregtari individual i cili ne kuader te veprimtarise se vet te regjistruar, lejon ose premtone se do t'i lejoje kredi konsumatorit;
3. "Marreveshje per kredi konsumi" eshte marreveshja me te cilen kreditori lejon ose premtone se do t'i lejoje konsumatorit kredi ne forme te huas, tejkalmimit te lejuar, pagimite prolonguar te prodhimit dhe sherbimeve, lizingut financiar ose sherbimittjeter te ngjashem financiar, pervec marreveshjeve per dhenie te sherbimeve ne baze te vazhdueshme ose per furnizim me prodhime te llojit te njejte te te cilat pagimi behet ne keste gjate periudhes se dhenies se sherbimeve dhe furnizimit me prodhime;
4. "Tejkalim i lejuar" eshte marreveshja eksplicite per kredi me te cilen kreditori ne llogari te konsumatorit leshon ne disponimmjete ne shume me te madhe se gjendja rrjedhese e mjeteve te kesaj llogarie;
5. "Tejkalim" eshte pranimi i heshtur i tejkalmimit ku kreditori ne llogari te konsumatorit leshon ne disponimmjete ne shumeme te madhe se gjendjarrjedhese e mjeteve te kesaj llogarie ose nese ekziston tejkalmimi i lejuar, shuma me te madhe se tejkalmimi i lejuar;
6. "Ndermjetesues i kredise" eshte personi fizik ose juridik i cili nuk eshte kreditor dhe ne kuader te veprimtarise se tij tregtare, afariste ose profesionale per kompensim, kryen nje ose me shume prej aktiviteteve si vijojne:
 - prezanton ose ofron marreveshje per kredi konsumi,
 - u ndihmon konsumatoreve me ndermarrjen e aktiviteteve pergatitese dhe per marreveshje tjera per kredi, pervec per marreveshje per kredi konsumi, ose

- lidh marreveshje per kredi konsumine emer dhe per llogarite kreditorit;
- 7. "Shpenzime te pergjithshme te kredise" jane te gjithashpenzimet, duke i perfshire kamatat, provizionet, donacionet dhe cfaredo kompensimesh tjera ne lidhje me marreveshjen per kredi konsumi te cilat konsumatori duhet t'i paguaje gjate lejimit dhe pageses serregullt te kredise dhe te cilati jane te njohura kreditorit, pervec shpenzimeve te noterit. Shpenzimet per sherbime plotesues lidhur me marreveshjen per kredi konsumi, duke i perfshire edhe premitet per sigurimin e kredise, gjithashtu hyjne ne shpenzimet e pergjithshme te kredise, nese lidhja e marreveshjes per sherbime plotesuese eshte e detyrueshme per marrjen e kredise ose per marrjen e saj me kushte te caktuara;
- 8. "Shuma e pergjithshme qe e paguan konsumatori" paraqet permbledhjen e shumes se pergjithshme te kredise dhe shpenzimeve te pergjithshme te kredise;
- 9. "Shkalle vjetore e shpenzimeve te pergjithshme" jane shpenzimet e pergjithshme te kredise, duke i perfshire edhe shpenzimet nga neni 20 paragrafi (3) te ketij ligji nese eshte e zbatueshme, te shprehura si perqindje vjetore e shumes se pergjithshme te kredise;
- 10. "Shkalle kamatore" eshte shkalle kamatore e shprehursi perqindje fikseose variable e treguar ne baze vjetore te pjeses se shfrytëzuar te kredise;
- 11. "Shkalle kamatore fikse" do te thote sekreditori dhe konsumatori pajtohen per nje shkalle kamatore gjate kohezgjatjes se marreveshjes per kredi konsumi ose per disa kamata te kredise per periudha te caktuara, te shprehura vecanerisht ne perqindje fikse. Nese ne marreveshjen per kredi konsumi nuk caktohen gjitha shkallet kamatore, shkalle kamatore do te konsiderohet se eshte fikse vetem per periudhat e caktuara per te cilat shkallet kamatore per caktohen vecanerisht ne perqindje fikse per te cilen eshte arritur pelqimigjate lidhjes se marreveshjes per kredi konsumi;
- 12. "Shuma e pergjithshme e kredise" eshte kufiri i eperme i kredise ose shuma e pergjithshme qe i lihet ne disponim konsumatorit ne pajtim me marreveshje per kredi konsumi;
- 13. "Medie e perhershme" eshte cdo instrument qe konsumatorit i mundeson t'i deponoje informatat derguara personalisht te ai ne menyre qe i mundeson shfrytëzim te ketyre informatave ne nje periudhe te caktuar kohore ne menyre adekuateme qellimin e informatave dhe qe lejon reproduksion te pandryshuar te informatave te deponuara dhe
- 14. "Marreveshje e lidhur per kredi" eshte:
 - marreveshja per kredi me te cilen financohet marreveshja per furnizim te mallrave ose sherbimeve dhe
 - marreveshje nga alineja 1 e kesaj pike qe paraqesin teresi komerciale. Teresi komerciale ekziston kur furnizuesi ose dhenesi i sherbimeve vet e financon kredine e konsumatorit, ose kur kredia financohet nga pala e trete, kur kreditori i shfrytëzon sherbimet e furnizuesit ose dhenesit te sherbimeve lidhur me lidhjen ose per gatitjen e marreveshjes per kredi konsumi, ose kur mallrat e caktuara, perkatesisht dhenia e sherbimeve te caktuara ne menyre eksplicite theksohen ne marreveshje per kredi konsumi.

Perjashtime

Neni 3

(1) Dispozitat e ketij ligji nuk zbatohen ne:

- 1) marreveshje per kredi qe sigurohen me hipoteke te prones se patundshme ose te drejtave tjera te prones se patundshme;
- 2) marreveshje per kredi qellimi i te cilave eshte marrja ose mirembajtja e te drejtesse pronesise se venditose ndertesese, e ndertuar ose ne ndertim;
- 3) marreveshje per kredine shuma me te larta se 75 000 euro ne kundervlere me denare;
- 4) marreveshjet per lizing ose per qira te sendeve te cilat me vet marreveshjen ose me marreveshjet vecante nuk parashihet obligim per blerje te sendeve ne fund te afatit kontraktues. Do te konsiderohet se

ekziston obligim per blerje edhe nese kreditori ne menyre te njeanshme ka vendosur keshtu;

5) marreveshje per kredi ne forme te tejklimit te lejuar me afat te pageses prej nje muaji;

6) marreveshje per kredi per te cilat nuk paguhet kamate dhe cfaredo shpenzimesh tjera dhe marreveshjeper kredi te te cilat kredia duhet te kthehetne afat prej tre muajsh dhe me pagim te kompensimeve te parendesishme;

7) marreveshje per kredi te cilat punedhenesi, jashte veprimtarise se tij tregtare,ua lejon te punesuarve pa kamate ose me shkallevjetore te shpenzimeve te pergjithshme me te ulet se ajo qe mbizoteronne treg dhe te cilatnuk i ofrohen publikut me te gjere;

8) marreveshje per kredi qe lidhen me personajuridike te cilet kryejne sherbimeme letra me vlere ne pajtim me Ligjin per letra me vlere, ose me bankatme qellim qe t'i mundesohet investuesit te kryejne transaksion qe lidhet me nje ose me me shume letra me vlere ne pajtim me Ligjin per letra me vlere,nese personat juridikeose banka qe e lejon kredine perfshihen ne transaksionin e ketille;

9) marreveshje per kredi te cilat jane rezultat i barazimit gjyqesorose barazimit para organit te administrates shteterore, si dhe pagimit te shtyreme dokument permbarues mendermjetesimin e permbaruesit;

10) marreveshje per kredi per pagimine shtyre te borxhit ekzistues, pa pagimin e shpenzimeve dhe

11) marreveshje per kredi qe kane te bejne me hua te lejuara per grup te caktuar te popullsiseqe eshte me interes te shtetit me shkalla me te uleta kamatore se ato qe mbizoterone ne treg ose pa shkalle kamatore,ose me kushte te ndryshmete cilat jane me te volitshme per konsumatorin dhe me shkallakamatore qe nuk jane me te larta se ato qe mbizoterone ne treg.

(2) Ne marreveshje per tejklimitin e lejuar dhe kur kredia duhet te kthehet me kerkese ose ne afat prej me se shumti tre muajsh, zbatohen vetem dispozitat e nenit 2, dispozitat nga paragrafi (1) i ketij neni, neni 4 paragrafet (1) dhe (2) pikat 1 dhe 2, nenet 6, 7, 8, 9, 10 paragrafet (1) dhe (3), 12, 15, 17 dhe 20 te ketij ligji.

(3) Ne rast te tejklimit zbatohen vetem dispozitat e nenit 2, paragrafi (1) i ketij neni dhe neni 18 i ketij ligji.

(4) Ne marreveshjet per kredi ne te cilat parashihet qe kreditori dhe konsumatori te kontraktohen per pagim te shtyre ose per menyrate pageses kur konsumatori nuk e ploteson obligimin per pagimin e marreveshjes themeloreper kredi, nese me marreveshjen e ketille parandalohet mundesia per proceduregjyqesore per shkak te mospagimit dhe konsumatori nuk do te fitoje kushte te pavolitshme te kushteve me te cilat lidhet marreveshja themelore, zbatohen vetem dispozitat nga neni 2, paragrafi (1) i ketijneni, nenet 4, 6, 7, 9, 10 paragrafet (1) pikat 1, 2,

3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 12 dhe 18, (2) dhe (3), 11, 13, 16 dhe 18 te ketij ligji.Nese marreveshjet e ketilla per kredi jane ne kuaderte marreveshjes per tejklimitin e lejuar, zbatohenvetem dispozitat e paragrafit (2) te ketijneni.

II. REKLAMIMI DHE OFERTA

Informata standardeqe duhet te perfshihenne reklamim

Neni 4

(1) Cdo reklamim ne lidhje me marreveshjet per kredite konsumi,i cili inicon shkalle kamatore ose te dhena te lidhura me shpenzimet per kredi, duhet t'i permbajeinformatat standarde nga paragrafet (2) dhe (3) te ketijneni.

(2) Informatat standardejepen ne menyrete qarte, precizedhe ne menyre qe lehte shihen nepermjetekzemplarit reprezentativ dhe kane te bejne me:

1) shkallenkamatore, fikse ose variabile ose mete dyjat, me detaje per te gjitha kompensimet te perfshira ne shpenzimet e pergjithshme te kredise se konsumit;

2) shumen e pergjithshme te kredise;

- 3) shkallen vjetore te shpenzimeve te pergjithshme, pervec per marreveshje nga neni 3 paragrafi (2) i ketij ligji;
 - 4) kohezgjatjen e marreveshjes per kredi konsumi, nese eshte e zbatueshme;
 - 5) shumen e pagesesme para te gatshme dhe lartesine e cfaredo pagesaveavance, ne rast te kredise ne forme te pagesesse shtyre per mallra ose sherbime te caktuara dhe
 - 6) shumen e pergjithshme te cilen e paguan konsumatori dhe shumen e kesteve, nese eshte e zbatueshme.
- (3) Kur lidhja e marreveshjes per sherbime plotesuese te lidhura me marreveshjen per kredi konsumi, vecanerisht marreveshja per sigurim, detyrohet per marrjen e kredise ose per marrjen e kredise ne pajtimme kushtet e reklamimit, ndersashpenzimi i ketijshperbimi nuk mund te caktohet prej perpara, obligimi per lidhjene kesaj marreveshje do te theksohet ne menyre te qarte, precizedhe te dukshme, se bashkume shkallen vjetorete shpenzimeve te pergjithshme.

Informata parakontraktuese

Neni 5

(1) Para se konsumatori te obligohet me oferte ose marreveshje per kredi konsumi, kreditori ose ndermjetesuesi i kredise detyrohen qe me shkrimose nepermjet ndonje medie tjeterte perhershme, ne baze te kushteve te ofruara te kredise, konsumatorit t'i japin informatane formular te vecante, te nevojshme per krahasim me oferta te ndryshme, me qellim te miratimit te vendimit per lidhjen e marreveshjes per kredi. Informatat kane te bejne me:

- 1) llojin e kredise;
- 2) emrin dhe mbiemrin, perkatesisht emrin dhe adresene kreditorit edhe nese zbatohet per ndermjetesuesin e kredise;
- 3) shumen e pergjithshme te kredise dhe kushtet per shfrytezimin e tyre;
- 4) kohezgjatjen e marreveshjes per kredi;
- 5) mallin ose sherbimindhe cmimin e tij me para te gatshme, ne rast te kredise ne formen e pagimit te shtyre per mallra ose sherbime te caktuara dhe marreveshjet e lidhura per kredi;
- 6) shkallen kamatore, kushtetme te cilat rregullohet zbatimii shkalles kamatore, dhe nese zbatohet cdo indeks ose shkalle referente e shkalles kamatorefilllestare, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat per ndryshimin e shkalles kamatore. Nese ne periudhate ndryshme zbatohenshkalle te ndryshmekamatore, te gjithainformatat e lartpermendura theksohen per cdo kamate;
- 7) shkallen vjetorete shpenzimeve te pergjithshme dhe shumen e pergjithshme te cilen e paguan konsumatori, te paraqitura nepermjetekzemplarit reprezentativ ne te cilin theksohen te gjitha parastresat per llogaritjen e shkalles vjetorete shpenzimeve te pergjithshme. Nese konsumatori e njofton kreditorin per nje ose me shume kushte te preferuara per kredine qe e kerkon, sic jane kohezgjatja e marreveshjes per kredi dhe shuma e pergjithshme e kredise, kreditoridetyrohet t'i kete parasysh keto kushte. Nese ne marreveshjen per kredi parashihen me shume menyrate shfrytezimit te kredise me shpenzime te ndryshme ose shkalla kamatore, kreditori detyrohet te theksoje se mekanizma tjeraper shfrytezimin e kredise, mund te shkaktojneshkalle me te larte vjetorete shpenzimeve te pergjithshme;
- 8) shumene kestit te vecante, numrin e kesteve dhe nese zbatohet rendi i arritjes se kesteve te cilat konsumatori duhett'i paguaje;
- 9) nese eshte e zbatueshme, shpenzimet per mbajtjene nje ose me shume llogarive ne te cilat evidentohen arketimetdhe pagesat e pjeses se shfrytezuar te kredise, pervecnese hapja e llogarise eshte opsionale, si dhe shpenzimet per perdorimin e mjetit te caktuar per pagimin e arketimeve dhe pagesave te pjeses se shfrytezuar te kredise, shpenzimet tjera te cilat dalin nga marreveshja per kredi dhe kushtet me te cilat keto shpenzime mund te ndryshohen;

- 10) ekzistimin e shpenzimeve te noterit qe i paguan konsumatori gjate lidhjes se marreveshjes, nese zbatohet;
 - 11) obligimin, nese ekziston, per lidhjen e marreveshjes per sherbime plotesuese lidhur me marreveshjen per kredi konsumi, si marreveshje per sigurim, nese lidhja e marreveshjes se ketille eshte e detyrueshme per marrjen e kredise ose per marrjene kredise ne pajtim me kushtet e reklamimit;
 - 12) shkallen kamatore te zbatueshme ne rast te pagesave te vonuara, kushtet per ndryshimin (pershtatjen) e saj dhe shpenzimet per mosplotesimin e obligimit;
 - 13) paralajmerimin per pasojat e mospagimit te kesteve;
 - 14) garancite per kredine, nese zbatohet;
 - 15) ekzistimin ose mungesen e te drejteste doreheqjes se marreveshjes;
 - 16) te drejten e pagimit te parakohshme te kredise dhe te drejten e kreditorit per kompensim dhe menyren e llogaritjes se kompensimit ne pajtim me nenin 16 i ketij ligji;
 - 17) te drejten e konsumatorit menjehere dhe falas qe te informohet per rezultatit e analizes te aftesise se tij te kreditit te marre ne baze te te dhenavenga baza e te dhenave, ne pajtim me nenin 9 paragrafi (2) i ketij Ligji;
 - 18) te drejten e konsumatorit qe te marre, me kerkese dhe falas, kopje nga draft- marreveshja per kredi konsumin. Kjo dispozite nuk zbatohet nese kreditori gjate kohes se parashtrimit te kerkeses nuk deshiron te qaset ne lidhjen e marreveshjes per kredi konsumime konsumatorin dhe
 - 19) afatin ne te cilin kreditori obligohetme informatat para kontraktuese, nese zbatohet.
- (2) Ne rast te komunikimit ne telefon ose mjetit tjeter per komunikim me ze ne largesi kreditoridetyrohet qe konsumatorit t'ia kumtoje informatat nga paragrafi (1) pikat 3, 4, 5, 6 dhe 8 te ketij neni, si dhe shkallen vjetorete shpenzimeve te pergjithshme, nepermjet ekzemplarit reprezentativ dhe shumes se pergjithshme te cilen e paguan konsumatori.
- (3) Nese marreveshja u lidh me kerkese te konsumatorit me shfrytezimin e mjeteve per komunikim ne largesi qe nuk mundesojnedenie te kushteve dhe informatave kontraktuese ne pajtim me paragrafin (1) i ketij neni, kreditoridetyrohet qe ta plotesoje obligimin menjehere me lidhjen e marreveshjes.
- (4) Kreditori detyrohet qe me kerkese te konsumatorit t'i siguroje, pervec formularit nga paragrafi (1) i ketij neni edhe kopje falas nga draft - marreveshja per kredi konsumi, pervec nese kreditori gjate kohes se parashtrimit te kerkeses nuk deshiron te qaset ne lidhjen e marreveshjes per kredi konsumime konsumatorin. Ky obligim nuk zbatohet nese kreditori nuk qaset ne lidhjen e marreveshjes me konsumatorin.
- (5) Kreditorit dhe ndermjetesuesit e kredive detyrohet t'i japin sqarime adekuat konsumatorit te cilat do t'i mundesojne te vleresojne nese marreveshja e propozuar per kredi konsumi u pershtatet nevojave te tyre dhe gjendjes se tij financiare, me sqarimine informatave nga paragrafi (1) i ketij neni, karakteristikave te rendesishme te prodhimit te propozuar dhe ndikimit te tyre mbi konsumatorin, duke i perfshire pasojat nga mospagimi i kredise.
- (6) Guvernatori i Bankes Popullore te Republikes se Maqedonise se Veriut e percakton formendhe permbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i ketij neni.

Informata parakontraktuese per marreveshje specifike per kredi

Neni 6

- (1) Me perjashtim te nenit 5 i ketij ligji, para konsumatorit qe te obligohetme marreveshje per kredi konsuminga neni 3 paragrafet (2) dhe (4) te ketij ligji ose me oferte, kreditori edhe nese zbatohet ndermjetesuesi i kredise duhet, ne baze te kushteve te kredive te ofruara nga kreditori dhe kerkeseve edhe nese zbatohen prioritetet dhe informatat e shprehura te

konsumatorit, ta sigurojne konsumatorin me informata te nevojshme per zbatimin e ofertave te ndryshme, me qellim te miratoje vendimper lidhjen e marreveshjes per kredi.

(2) Informatat nga paragrafi (1) i ketij neni kane te bejne me:

- 1) llojin e kredise;
- 2) emrin dhe mbiemrin, perkatesisht emrin dhe adresene kreditorit, nese zbatohet per ndermjetesuesin e kredise;
- 3) shumen e pergjithshme te kredise;
- 4) kohezgjatjen e marreveshjes per kredi;
- 5) shkallen kamatore,kushtet me te cilat rregullohet zbatimi i shkalleskamatore, dhe nese zbatohet cdo indeks ose shkalle referuese qe zbatohet ne shkallen kamatorefilltare, shpenzimet qe krijohen me lidhjen e kredise edhe nese zbatohet, kushtet me te cilat mund te ndryshohen keto shpenzime;
- 6) shkallen vjetorete shpenzimeve te pergjithshme, e paraqitur nepermjetekzemplareve reprezentative ne te cilat theksohen te gjitha parashtraset per llogaritjen e shkalles vjetorete shpenzimeve te pergjithshme;
- 7) kushtet dhe proceduren per pushimin e marreveshjes per kredi;
- 8) tek marreveshjet per kredi nga neni 3 paragrafi (2), dispozita se nga konsumatori mund te kerkohetta paguaje gjitheshumen e kredisene cilendo kohe nese zbatohet;
- 9) shkallen kamatorene rast te pagimit te vonuar dhe kushtet per pershtatjen e saj dhe nese zbatohet,shpenzimet per mosplotesimin e obligimit per pagim;
- 10) tedrejtjen e konsumatorit menjehere dhe falas qe te informohet per rezultatin eanalizes se aftesise se tij te kredititte marre ne baze te te dhenavenga baza e te dhenave,ne pajtim me nenin 9 paragrafi (2) i ketij Ligji;
- 11) shpenzimet qe krijohen me lidhjen e marreveshjes dhe kushtet me te cilat mund te ndryshohen keto shpenzime, ne rast te marreveshjes per kredi nga neni 3 paragrafi (2) i ketijligji dhe
- 12) afatin ne te cilin kreditori obligohetme informatat para kontraktuese, nese zbatohet.

(3) Informatat nga paragrafi (2) i ketij neni sigurohenne leter ose ne ndonje medie tjeter te perhershmedhe duhet te theksohen ne menyre te barabarte. Informatat e ketilla mund te jepen ne formularin nga neni 5 paragrafi (1) i ketij ligji.

(4) Ne rast te marreveshjes per kredi nga neni 3 paragrafi (2) i ketij ligji nuk theksohet shkalla vjetore e shpenzimeve te pergjithshme.

(5) Ne rast te marreveshjes per kredi nga neni 3 paragrafi (4) i ketij ligji, pervec informatave nga paragrafi (2) i ketijneni, konsumatorit i jepen edhe informata si vijojne:

- shuma e keshtit te vecante, numri i kestevedhe nese eshte e zbatueshme, rendi i arritjesse kesteve dhe

- e drejtae pagimit te parakohshem te kredise dhe e drejtae kreditorit te kompensimit te drejte per shpenzimet qe ne menyre te drejtperdrejte lidhen me pagimin e parakohshem te kredise ne pajtim me nenin 16 paragrafi (2) i ketijligji.

Ne rast te marreveshjes nga neni 3 paragrafi (2) i ketij neni zbatohetvetem paragrafi (1) i ketij neni.

(6) Ne rast te komunikimit ne telefon dhe kur konsumatori kerkon qe menjeheret'i lihet ne disponim tejkalmii lejuar i llogarise, pershkrimi i karakteristikave kryesorete sherbimeve financiarei perfshine me se paku informatat nga paragrafi (2) pikat 3, 5, 6 dhe 8 te ketij neni.

(7) Pa qene ne kundershtim me nenin 3 paragrafi (1) pika 5 e ketij ligji, te marreveshjet per tejkalimin e lejuar me afat te pageses prej nje muajikonsumatorit i jepeninformatat nga paragrafi(2) pikat 3, 5, 6 dhe 8 te ketij neni.

(8) Kreditori detyrohetqe me kerkese te konsumatorit t'i siguroje, krahasinformatave nga paragrafet(2), (3), (4) dhe (5) te ketij neni, kopje falas nga draft - marreveshja per kredi konsumi, qe i permban informatat nga neni 10 i ketij ligji, pervec nese kreditorigjate kohes se parashtrimit te kerkeses nuk deshiron te qaset ne lidhjen e marreveshjes per kredi konsumime konsumatorin.

(9) Nese marreveshja u lidh me kerkese te konsumatorit me shfrytezimin e mjeteve per komunikim ne largesi qe nuk mundesojne dhenie te informatave nga paragrafet (2) dhe (4) te ketij neni, duke e perfshireedhe rastin nga paragrafi (5) i ketij neni, kreditori detyrohet qe ta plotesoje obligimine vet nga paragrafet (2) dhe (4) te ketij neni, menjehere me lidhjen e marreveshjes, me sigurimin e informatave kontraktuese nga neni 10 i ketijligji.

Perjashtime nga obligimi per dhenien e informatave parakontraktuese

Neni 7

Dispozitat nga nenet 5 dhe 6 te ketij ligji nuk zbatohen per furnizuesit e mallrave dhe sherbimeve, te cilat paraqitenne cilesi te ndermjetesuesve te kredive, pa qene ne kundershtim me obligimet e kreditorit per dhenien e informatave para kontraktuese te konsumatorit.

Obligimi per vleresimin e aftesise se kredise te konsumatorit

Neni 8

(1) Para lidhjesse marreveshjes per kredi konsumi,kreditori duhet ta vleresoje aftesine kredise se konsumatorit ne baze te informatave te mjaftueshme te marra nga ane e konsumatorit ose, nese nevojitet, nga baza relevante e te dhenave.

(2) Pavaresisht nga paragrafi (1) i ketij neni, bankatdhe kursimoret bejne vleresimin e aftesise se kredise te konsumatorit dhe ne baze te rregullave me te cilat rregullohet puna e bankave dhe kursimoreve.

(3) Nese palet kontraktuese me lidhjen e marreveshjes per kredi konsumipajtohen qe ta ndryshojne shumen e pergjithshme te kredise, kreditoridetyrohet qe t'i plotesoje informatat financiare plotesuese per konsumatorin dhe perseri ta vleresoje aftesine tij te kredise para rritjes se konsiderueshme te shumes se pergjithshme te kredise.

(4) Sipas nevojës, guvernatori i Bankes Popullorete Republikes se Maqedonise se Veriut do ta rregullojerritjen e konsiderueshme te shumes se pergjithshme te kredive nga paragrafi (3) i ketij neni te cilat i lejojne bankat dhe kursimoret.

III. QASJA NE BAZEN E TE DHENAVE

Neni 9

(1) Nese krediti lejohet ne vendin anetar te BashkimitEvropian, kreditori i ketij vendi mund t'i shfrytezoje te dhenat nga baza e te dhenavene Republiken e Maqedonise se Veriut per vleresimin e aftesise se kredise te konsumatoreve, ne baze te kushteve jodiskriminuese.

(2) Nese kerkesaper kredi refuzohetne baze te te dhenave te marra nga bazat e te dhenave, kreditoridetyrohet pa shtyrjedhe falas ta njoftoje konsumatorin ne menyre te detajuar per te dhenat ne baze te te cilave e ka miratuarvendimin.

(3) Informatat nga paragrafi(2) i ketij neni sigurohen ne te gjitharastet, pervec nese dhenia e ketyre informatave ndalohet me ligj.

III. MARREVESHJA PER KREDI KONSUMI

Informata qe duhet t'i permbajne marreveshjet per kredi

Neni 10

(1) Marreveshja per kredi konsumi lidhet ne forme meshkrim ose permes ndonje medie tjeter te perhershme, ne ekzemplare te mjaftueshem per te gjithapalet kontraktuese.

(2) Marreveshja per kredi, pervec marreveshjes per tejkalimin e lejuar, ne menyre te qarte dhe precize permbaninformata se paku per:

1) llojin e kredise;

2) emrin dhe mbiemrin dhe adresen e konsumatorit, perkatesisht emrin dhe selinee kreditorit, dhe nese zbatohetper ndermjetesuesin e kredise;

3) kohezgjatjen e marreveshjes per kredi;

4) shumen e pergjithshme te kredise dhe kushtet per shfrytezimin e tij;

5) vleren e mallit ose sherbimeve te caktuara, ne rast te kredise ne forme te pagimit te shtyre per mallra ose sherbime te caktuara ose marreveshjes se lidhur per kredi;

6) shkallen kamatore, kushtetme te cilat rregullohet zbatimii shkalles kamatore,dhe nese zbatohetcd indeks ose shkalle referuese e shkalles kamatorefilllestare, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat per ndryshimin e shkalles kamatore. Nese ne periudhate ndryshme zbatohen shkalle te ndryshme kamatore,theksohen informatat per te gjithashkallet e zbatueshme;

7) shkallen vjetorete shpenzimeve te pergjithshme dhe shumen e pergjithshme te cilen e paguan konsumatori, te llogaritura gjate kohes te lidhjes se marreveshjes per kredi, me c'rast theksohente gjitha parashtresat te cilat shfrytezohen gjate llogaritjes se shkalles;

8) shumen e keshtit te vecante, numrin e kestevedhe nese zbatohetrendi i arritjes se kesteve;

9) te drejtene konsumatorit me kerkese dhe falas qe te marre, gjate pageses te kryegjesese marreveshjes per kredi me kohezgjatje fikse, ne cilendo kohe gjate kohezgjatjes se marreveshjes per kredi, raportinper llogarine ne forme te planit te amortizuar. Plani amortizues permbante dhena per kestet dhe afatin e arritjes se tyre dhe kushtet ne lidhje me pagesen e ketyre shumave, kontrollin e cdo pagese me te dhena per kryegjene, kamaten e cila llogaritet ne baze te shkalles kamatore, nese zbatohetdhe shpenzimet plotesuese. Nese shkalla kamatorenuk eshte fikse oseme marreveshjen per kredi jepet mundesia qe shpenzimet plotesuese te ndryshohen, ne planin amortizuesne menyre te qarte dhe precize verehetse te dhenat e permbajtura ne planin vlejne vetem deri ne momentinkur shkalla e ngarkimit me borxh ose shpenzimet plotesuese do te ndryshojnene pajtim me marreveshjen per kredi;

10) periudhen dhe kushtet per pagimin e kamates dhe shpenzimeve; nese kamata dhe shpenzimet paguhenpa pagesen e kryegjese;

11) obligimin per lidhjen e marreveshjes per sherbime plotesuesete lidhur me marreveshjen per kredi konsumi,si marreveshja per sigurim, nese lidhja e marreveshjes se ketille eshtee detyrueshme per marrjen e kredise ose per marrjen e kredisene pajtim me kushtet per reklamimin;

12) kamaten ndeshkimore gjate kohes te lidhjes se marreveshjes per kredi, kushtet per pershtatjene saj dhe shpenzimet per mosplotesimin e obligimit per pagim;

13) paralajmerimin per pasojat e mospagimit te kesteve;

14) sipas nevojes,deklaron se shpenzimet e noterit do t'i paguajekonsumatori;

15) garancite dhe sigurimin per kredine, nese i ka;

16) ekzistimin ose mungesen e te drejtes se doreheqjesnga marreveshja per kredi, periudhenne te cilen kjo e drejte mund te realizohet dhe kushtet tjera per zbatimine saj, duke i perfshireinformatat te cilat kane te bejne me obligimin e konsumatorit qe ta paguaje shumen e pjeses se shfrytezuar nga kryegjeja dhe kamaten ne pajtim me nenin 14 paragrafi (3) pika 2 e ketij ligji dhe lartesine e kamates ditore;

17) te drejtatq dalin nga neni 15 i ketijligji dhe kushtetper realizimin e tyre;

18) te drejtat e pagimit te parakohshem te kredise, procedurene pagimit te parakohshem dhe te drejtene kredise se shpenzimeve per arketimin e parakohshem te kredise dhe menyren e llogaritjes se ketyre shpenzimeve

ne pajtim me nenin 16 i ketij ligji.

19) proceduren per realizimin e te drejtesper prishjen e marreveshjes per kredi;

20) te drejten e zgjidhjes jashtegjyqesore te kontesteve dhe menyren e shfrytezimit te kesaj te drejte;

21) emrin e selise se organit kompetent te supervizorit, nese eshte e zbatueshme dhe

22) informatat tjerakontraktuese, nese eshte e zbatueshme.

(3) Marreveshja per tejkalimin e lejuar ne menyre te qarte dhe precize permbaninformatat per:

1) llojin e kredise;

2) emrin dhe mbiemrin dhe adresen e konsumatorit, perkatesisht emrin dhe selinee kreditorit, dhe nese zbatohetper ndermjetesuesin e kredise,

3) kohezgjatjen e marreveshjes per kredi;

4) shumen e pergjithshme te kredise dhe kushtet per shfrytezimin e saj;

5) shkallen kamatore dhe kushtet me te cilat rregullohet zbatimi i shkalleskamatore dhe nese eshte e zbatueshme, cdo indeks ose shkalle referuese e shkalles kamatorefillestare, si dhe periudhat, kushtet dhe rendi per ndryshimin e shkalles kamatore.Nese ne periudhe te ndryshme zbatohen shkallete ndryshme kamatore,dhe nese zbatohet,theksohen te gjithainformatat e lartpermendura;

6) dispozitat se nga konsumatori mund te kerkohet qe ta paguaje gjithe shumen e kredise ne cdo kohe;

7) kushtet per realizimin e te drejtesper doreheqje nga marreveshja per kredi dhe

8) Informatat per shpenzimet gjate kohes te lidhjes se marreveshjes per kredi dhe kushtet me te cilat keto mund te ndryshohen.

Informata per shkallen kamatore

Neni 11

(1) Nese eshtee zbatueshme, konsumatori duhet te njoftohetper cdo ndryshim te shkalleskamatore te kredise ne forme me shkrim ose permes ndonje medie tjeter te perhershme para sete filloje te zbatohet. Njoftimipermban te dhenaper shumen e pagesave per ndryshimin e shkalles kamatore dhe detajet per numrin e periudhave te pagimit, nese ndryshohen.

(2) Me perjashtim te paragrafit (1) i ketijneni kreditori dhe konsumatori mund te kontraktohen qe njoftimin nga paragrafi (1) i ketij neni ta japin periodikisht nese ndryshimi i shkalles kamatoreshkaktohet nga ndryshimi i shkalles referuese qe publikisht shpallet dhe theksohet ne lokalet e kreditorit.

Obligime ndaj marreveshjes per tejkalimin e lejuar

Neni 12

(1) Te marreveshjet per tejkalimin e lejuar kreditori detyrohet qe rregullisht, ne forme me shkrim ose permes ndonje medie tjeter te perhershme, t'i dergoje konsumatorit raport per gjendjene llogarise i cili i permban:

1) periudhen me te cilen ka te beje raporti;

2) shumat dhe datat e arketimeve dhe pagesave;

3) gjendjen dhe daten e raportit paraprak;

4) gjendjen e re;

5) shkallen e vlefshme kamatore;

6) shpenzimet qe arketohen dhe

7) shumen minimaleper pagim, nese zbatohet.

(2) Kreditori duhet ta njoftojekonsumatorin, ne forme me shkrim ose permes ndonje medie tjeter te perhershme, per rritjen e shkalles kamatoreose shpenzimeve qe paguhen para se filloje te zbatohet.

(3) Me perjashtim te paragrafit (2) i ketij neni kreditoridhe konsumatori mund te kontraktohen qe raporti nga paragrafi (1) i ketijneni te jepet periodikisht nese ndryshimi i shkalles kamatoreshkaktohet nga ndryshimi i shkalles referueseqe publikisht shpalletdhe theksohet ne lokalet e kreditorit.

Marreveshje per kredi pa afat te maturimit

Neni 13

(1) Konsumatori mund ta shfrytezoje te drejten e doreheqjes nga marreveshja per kredi pa afat te maturimit, pa pagim te shpenzimeve plotesuese dhe ne cilendokohe, nese ne marreveshje nuk parashihet prej perparata njoftoje kreditorin per doreheqje, ne afat jo me gjate se 30 dite.

(2) Kreditori mund ne forme me shkrim ose permesndonje medie tjeter te perhershme ta njoftoje konsumatorin se jep doreheqjenga marreveshja per kredi pa afat te maturimit, se paku 60 dite para doreheqjes, nese keshtu caktohetne marreveshje.

(3) Kreditori mund nga shkaqe te arsyetuarat'ia anulohet te drejten konsumatorit per disponim me mjetet, nese keshtu kontraktohet ne marreveshjen per kredi pa afat te maturimit. Kreditoridetyrohet qe ta njoftoje konsumatorin per shkaqet e doreheqjes ne forme me shkrim ose permes ndonje medie tjeter te perhershme para vete doreheqjes, e me se voni menjehere pas doreheqjes, pervec nese njoftimii ketille eshte ne kundarshtim me ligjin.

(4) Shkaqet e arsyetuara per doreheqje nga paragrafi (3) i ketij neni mund te jene dyshimi i arsyetuar per shfrytezimin e paautorizuar te kredise, dyshimii arsyetuar per mashtrim lidhur me kredine, rritja e konsiderueshme e rrezikut se konsumatori nuk do t'i plotesoje obligimete veta per pagimin e kredise dhe situatat tjerate ngjashme.

E drejta e prishjes se marreveshjes per kredi

Neni 14

(1) Konsumatori mund ta prishe marreveshjen e kredise ne afat prej 14 ditesh,pa e theksuar shkakun e prishjes. Afati i prishjesfillon te rrjedhe:

-nga dita e lidhjesse marreveshjes ose

-nga dita kur konsumatori i ka marre dhe informatatdhe kushtet nga marreveshja ne pajtim me nenin 10 i ketijligji, nese kjo dite eshte me e vonshme se dita e lidhjes se marreveshjes.

(2) Ne rast te marreveshjeve te lidhura per kredi kur mjetet i lihen ne disponim konsumatorit pas kalimit te periudhes se caktuar, konsumatori me kerkese mund te jep doreheqje nga marreveshja per kredi deri ne kalimine kesaj periudhe.

(3) Nese konsumatori e shfrytezon te drejten e doreheqjes nga marreveshja per kredi, ai duhet:

1) ta njoftoje kreditorin ne forme me shkrim ose permes ndonjemedie tjeter te perhershme per doreheqjen nga marreveshja per kredi, para kalimit te afatit nga paragrafi (1) i ketij neni dhe

2) ta paguaje kryegjene dhe kamaten per periudhen e shfrytezimit te kredise deri ne ditene pagimit te kryegjese, menjehere e jo me vone se 30 dite nga dita e njoftimit te kreditorit per doreheqjen e kredise. Kamatallogaritet ne baze te shkallesse kontraktuar kamatore.Kreditori ka te drejte kompensimi te shpenzimeve te pakthyeshme qe jane paguarne lidhje me marreveshjen per kredi ne organet publikeose shteterore.

(4) Nese kreditori ose pala e trete, ne baze te marreveshjes per sherbimet plotesuese, japin sherbime plotesuese ne lidhje me marreveshjen per kredi, konsumatori nuk obligohet me marreveshjen e ketille, nese e ka shfrytezuar te drejten e vet te doreheqjes nga marreveshja per kredi ne pajtim me paragrafet (1) dhe (2) te ketijneni.

(5) Dispozitat nga paragrafet (1), (3) dhe (4) te ketij neni nuk zbatohen per prishjen e marreveshjeve te lidhura ne largesi ne pajtim me Ligjin per dhenien e sherbimeve financiare ne largesi.

Marreveshje te lidhura per kredi

Neni 15

(1) Kur konsumatori e shfrytëzon te drejten e prishjes se marreveshjes per furnizimin e mallit te caktuar ose dhenies se sherbimit, ai me nuk eshte i lidhur me marreveshjen e lidhur per kredi.

(2) Nese mallrat ose sherbimet nga marreveshja e lidhur per kredi nuk sigurohen, perkatesisht nuk jane dhene, ose vetem pjeserisht sigurohen, perkatesisht jane dhene, ose nuk janene menyre adekuate me marreveshjen, konsumatori ka te drejte te kerkoje kompensim nga kreditori, nese konsumatori ka theksuar kundërshtim kunder furnizuesit te mallrave, perkatesisht dhenesit te sherbimeve, por nuk ka marre kompensim adekuat.

Pagesa e parakohshme e kredise

Neni 16

